



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2081/4 Prot.

Tiranë, më 05.10.2020

VENDIM

Nr. 35, datë 28.09.2020

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIM NË DOKUMENTACIONIN PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË,**

Në mbështetje të ligjit, nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", neni 2, 3 dhe 4, Statutit të UMT-së, VKM-së nr.40, datë 23.01.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.269, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," e ndryshuar, VKM-së nr.251, datë 27.03.2020 "Për një ndryshim në vendimin nr.269 , datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve,..." e ndryshuar, Vendimin Qarkullues nr.81, datë 17.09.2020 "Për miratimin e një ndryshimi..."Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim materialin e Administratorit të UMT-së nr.2030/2 prot, datë 21.09.2020 "Për miratimin e dokumentacionit për një kriter në formularin e aplikimit për përjashtim nga tarifa e shkollimit",

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentacionin që studentët e ciklit të parë dhe të integruar, duhet të dorëzojnë për plotësimin e kriterit me *njërin prind invalid me aftësi të kufizuar*, për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit. Formulari tip bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETARI

FLORIAN TOTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

<b>FORMULAR APLIKIMI PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT.</b>	
<b>VITI AKADEMIK _____</b>	
<i>Për studentët që ndjekin studimet në programet e ciklit të parë dhe të ciklit të integruar.</i>	
<b>Datëlindja</b>	
<b>Nr. ID</b>	
<b>Viti i Studimit</b>	
<p>Unë _____, student pranë Fakultetit të _____, paraqes kërkesën për të përfituar perjashtim nga tarifa, <b>pasi plotësoj kushtet e përcaktuara në VKM nr.40, date 23.01.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr.269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave, ...”ar</b>, Deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërit prej kriterëve të renditura në vijim të kërkesës, të nënvizuara me <b>shenjën X përbri kriterit</b>, janë në dijeninë time të sakta dhe janë dokumenta zyrtare të marra nga institucione shtetërore dhe/ose të njohura me ligj.</p> <p>Jam në dijeni se deklarime të rreme nga ana ime në këtë kërkesë si dhe paraqitja e dokumentave të falsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht dhe heqjen e të drejtës për përfitim të bursës. Dokumentat shoqëruese janë origjinale ose kopje të noterizuara sipas kërkesës.</p>	
	<b>Nënshkrimi</b>
<b>Kriteret për përfitimin e perjashtimit nga tarifa për studentët e Fakultetit të _____, Tiranë, për vitin akademik _____.</b>	
<b>Studentët në nevojë:</b>	<b>1.--Studentët , familjet e te cileve trajtohen me ndihmë ekonomike</b>
<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>	
1. Fotokopje të kartës së ID; <input type="checkbox"/>	
2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; <input type="checkbox"/>	
3. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet numri i dosjes– dokument origjinal lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore. <input type="checkbox"/>	

Studentët në nevojë:	2.—Studentët bashkëshortë, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy student.
<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fotokopje të kartës së ID; ■</li> <li>2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; ■</li> <li>3. Vërtetim studenti për bashkëshorten apo bashkëshortin student (e) - dokument origjinal ■</li> </ol>	
Studentët në nevojë:	3.—Studentë me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fotokopje të kartës së ID; ■</li> <li>2. Vërtetim lëshuar nga KMCAP (dokument fotokopje e noterizuar); ■</li> <li>3. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar – dokument origjinal lëshuar nga institucionet përkatëse. ■</li> </ol>	
Studentët në nevojë:	4.—Studentë që i kanë të të paktën, njërin prind me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar
<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fotokopje të kartës së ID; ■</li> <li>2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit ■</li> <li>3. Vërtetim lëshuar nga KMCAP (dokument fotokopje e noterizuar). ■</li> <li>4. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar – dokument origjinal lëshuar nga institucionet përkatëse. ■</li> </ol>	
Studentët në nevojë:	5.—Studentë që kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton.
<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fotokopje të kartës së ID; ■</li> <li>2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit: ■</li> <li>3. Vërtetim nga sigurimet shoqërore për pension pleqërie për prindërit- dokument origjinal; ■</li> <li>4. Certificate vdekje e prindit. (në rast se njëri nga prindërit pensionist nuk jeton) ■</li> </ol>	
Studentët në nevojë:	6.—Studentët të cilët janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve , në familje me tre fëmijë a me shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë.

**Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:**

1. Fotokopje të kartës së ID; ■
2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit: ■
3. Vërtetim studenti për dy femijët e lindur (vëllezerit dhe motrat) para studentit aplikues; ■

**Studentët në nevojë:****7.—Studentë, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.****Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:**

1. Fotokopje të kartës së ID. ■
2. Fotokopje e noterizuar e dokumentit për statusin e jetimit. ■
3. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit. ■
4. Çertifikatë e humbjes së dy prindërve. ■

**Studentët në nevojë:****8.—Studentë të cilët kanë humbur kujdestarinë prinderore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri 25 vjeç.****Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:**

1. Fotokopje të kartës së ID; ■
2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit: ■
3. Fotokopje e noterizuar e vendimit të Gjykatës i formës së prerë. ■

**Studentët në nevojë:****9.-- Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç.****Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:**

1. Fotokopje të kartës së ID; ■
2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit: ■
3. Dokumentit vërtetues lëshuar nga organet përkatëse, për studentët që kanë përfituar statusin ligjor si viktime të trafikut. Dokument origjinal/fotokopje e noterizuar. ■

**Studentët në nevojë:****10.-- Studentët të cilët janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për ceshtjet e brendshme dhe ankesat, të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.****Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:**

1. Fotokopje të kartës së ID; ■
2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit ■
3. Çertifikatë e humbjes së jetës së prindit (njërit); ■
4. Vërtetim të lëshuar nga institucioni përkatës i humbjes së jetës së prindit në krye të detyrës – dokument origjinal. ■

Studentët në nevojë:	11.—Studentët romë dhe egjyptianë, të cilët do të identifikohen nepërmjet vetëdeklarimit.
<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fotokopje të kartës së ID;</li> <li>2. Vetëdeklarim noterial.</li> </ol>	
Studentët në nevojë:	12.—Studentë, femijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose femijë me prindër të denuar politik me heqje lirie.
<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fotokopje të kartës së ID. ■</li> <li>2. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie; ■</li> <li>3. Vërtetim i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik- dokument original; ■</li> <li>4. Dëshmi penalteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – dokument origjinal. ■</li> </ol>	

**Nuk përfitojne përjashtim nga tarifa e shkollimit:**

- a) Studentët që kanë mbaruar studimet në një program studimi dhe vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.
- b) Studentët persëritës me përjashtim të rasteve të forcave madhore.

**Emër mbiemri i studentit**